# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446415**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Puna e SPAK, efektive”, mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/15/mesazhe-te-forta-nga-zyrtari-i-dash-lawton-po-punojme-me-shqiperine-per-te-goditur-organizatat-kriminale-transnacionale/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 14:45:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 14:44:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 14:43:00 UTC → 15 shtator 2026, 14:45:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1a7c41f30d601f5a29d8daf8cb24cb312726b037ed5943378f70f4461e03d97d` |
| TEKSTI | `8e3addc68f30ea64d29d3ee10f47ba6d09604737a14b857cfb3cd4c112401ebf` |
| PAMJA | `31610c9ee505c693171b6c94f4e4a05b0d16433dfcbb3c33becbdf1cc608c302` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0799cefddf5dec12e59616c07efc214a2a5de7b155c957aefa52a1c8a551fc0a` |
| E MËPARSHMJA | `ef32ba5960acfacd78acbfd2bdc6546a70ecd90781575269ef05997798a3619f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0799cefddf5dec12e59616c07efc214a2a5de7b155c957aefa52a1c8a551fc0a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | KRYESORE | TË FUNDIT

# "Puna e SPAK, efektive", mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale

15/09/2026 21:44




**Zyrtari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Daniel Lawton, gjatë seancës dëgjimore "Politika e SHBA dhe sfidat e sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor" e vlerësoi Shqipërinë një partner të rëndësishëm në strategjinë e shpalosur nga administrata amerikane e Donald Trump, ndërsa theksoi bashkëpunimin për të luftuar kërcënimet e krimit të organizuar ndërkombëtar në vend.**

Gjithashtu deklaroi se po punohet për të zhvilluar aftësitë në lidhje me sigurinë kibernetike. Zvndihmës sekretari i Byrosë së Cështjeve Europiane dhe Euroaziatike në Departamentin e Shtetit shpalosi strategjinë për të promovuar stabilitetin, edhe nxitjen e investimeve, prokurimet e sigurta për të avancuar interesat amerikane në rajon.

"Ne po punojmë ngushtë me aleatin tonë të NATO-s, Shqipërinë, për të goditur organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen e kompanive amerikane në treg. Një hua e finalizuar së fundmi në kuadër të Financimit të Huaj Ushtarak do ta ndihmojë Shqipërinë të përmbushë angazhimet e NATO-s për shpenzimet e mbrojtjes dhe të rrisë blerjen e pajisjeve të prodhuara në SHBA", deklaroi ai.

Në raportimin e republikanëve me dëshminë e zyrtarit Laëton u bë me dije se rivalët gjeopolitikë si Kina dhe Rusia përbëjnë një rrezik në rajon. Dhe strategjia amerikane bazohet në tre shtylla: ruajtja e stabilitetit, prosperitetit dhe goditja e pamëshirshme e rrjeteve kriminale.

"Shtetet e Bashkuara synojnë një Ballkan Perëndimor të qëndrueshëm, paqësor dhe të begatë, që kontribuon në sigurinë rajonale dhe globale. Ne po zhvillojmë marrëdhënie pozitive me aktorët kryesorë në rajon për të ruajtur stabilitetin, për të zgjeruar bashkëpunimin ekonomik dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve që prekin drejtpërdrejt Shtetet e Bashkuara", u shpreh zyrtari.

Lawton u ndal edhe te marrëdhënia SERBI Kosovë ku nënvizoi me rëndësi e thelbësor normalizimin e dialogut.

"Dialogu nga Bashkimi European ka ngecur për shkak të mungesës së vullnetit politik nga të dyja palët. Ne vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të shmangin provokimet, të respektojnë angazhimet dhe të rifillojnë bisedimet e drejtpërdrejta pa parakushte", tha ai.

I pyetur për sa i përket integrimit të rajonit në Bashkimin European, zyrtari i lartë i DASH tha se Shtetet e Bashkuara nuk marrin një pozicionim, por që u shpreh në ndihmë të procesit dhe në mbështetje të reformave që sipas tij kanë pasur ndikim me avantazh për rajonin, pavarësisht disa përplasjeve me BE. Ndërsa nuk pati një koment në lidhje me protestat në Shqipëri dhe emrin e Jared Kushner të përmendur në Dhomën e Përfaqësuesve të Komitetit të Jashtëm. Efekt

## Kryesore



Vendimi 3 me 0 ndaj Veliajt/ Gjykata e Lartë la në fuqi Apelin, ja çfarë thoshte një vit më parë për paraburgimet
11:46

Korrupsion dhe shpërdorim detyre në Policinë e Durrësit, AMP arreston një efektiv dhe nis procedimin për dy të tjerë
11:29

Rreth 4 mijë kredi për çiftet e reja/ Shteti garanton huanë pa parapagim, 2 mijë kuota me interes zero në 2027
15:18

Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës, GJKKO lë në burg ish-presidentin
12:17

## Më të lexuarat

"Daja i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 34-vjeçares, publikon foton e tyre si çift: Më thanë se do martohen

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

"Kryetari i pagëzuar rishtaz nga Kushtetuesja nuk mund të lëvizë nga qelia"/ Vendimi për Veliajn, Rama: Rast unikal në historinë e Europës demokratike

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"Do të vras po tregove"/ Rrëfimi tronditës i 34-vjeçares nga Roskoveci: Daja i deputetes Zegjine Çaushi më rrëmbeu dhe përdhunoi, më premtoi punë se njihte shefat

U dënua me 20 vite burg për gjakmarrje dhe më pas u shpall i pafajshëm, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim çështjen e Ergys Kolaverit

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

Vendimi 3 me 0 ndaj Veliajt/ Gjykata e Lartë la në fuqi Apelin, ja çfarë thoshte një vit më parë për paraburgimet

Alarm në ujërat ndërkombëtare, fregata ruse lëshon dy raketa drejt një helikopteri danez

"Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat", analisti Sulo ngre alarmin: Ç'po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s'i ka shpëtuar arrestit

Top Channel

## Aktualitet »



"Daja i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 34-vjeçares, publikon foton e tyre si çift: Më thanë se do martohen

15/09 21:51



Censi i Bujqësisë shtyhet sërish, numërimi i fermave dhe gjësë së gjallë në vjeshtën e 2027

15/09 20:22



Tubimi i 108-të poshtë zyrës së kryeministrit Rama, vijojnë fjalimet e protestuesve

15/09 20:20



Ligji i ri për lobimin, komisioneri: T'i japim dritë një mjedisi që shpesh shihet si "korridor i errët"

15/09 20:13



Video/ "Paga e magjistarëve…", lapsusi i deputetes së PS në Komisionin Parlamentar, Bylykbashi: Lapsus ishte, mos e bëni kaq të madhe

15/09 17:58



Parakalim i gabuar në superstradën Lezhë-Shkodër, disa të plagosur pas aksidentimit të dy makinave

15/09 17:18

## Kryesore »



Japonia thyen rekorde, kalon për herë të parë shifrën e 100 mijë persona mbi moshën 100-vjeçare, pjesa më e madhe janë gra

15/09 23:00



Liverpooli e mbyll me "tripletë", Tottenhamit i shuhet ëndrra në Carabao Cup

15/09 23:00



"Po e vendosin njerëzimin në rrugën e shkatërrimit", Rusia sulmon SHBA-në pasi pranoi se ka sisteme armësh në hapësirë

15/09 22:40



Rama udhëton drejt SHBA-së në 20 shtator, zbardhen detaje nga takimet që pritet të zhvillojë

15/09 22:40



Danimarka raporton tentativë sulmi, akuzon anijen luftarake ruse: Qëlloi me fishekzjarrë helikopterin ushtarak

15/09 22:37



SHBA nis shkurtimet në Ballkan/ Ndihmë ushtarake vendeve të Amerikës së Jugut, preket Maqedonia e Veriut

15/09 22:33

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »









Top Channel/ SHBA nis shkurtimet për ushtrinë në Ballkan, preket Maqedonia e Veriut

Top Channel/ Dyfishohet bonusi për pensionistët, vendimi nis më 1 janar 2027

Top Channel/ "Ethet" e vendimit në Hagë, nesër verdikti i gjykatës për liderët e UÇK

Top Channel/ Misteri i vdekjes së Giorgos Mazonakis/ Fotoja e fshehtë që mund të ndryshojë hetimin

Top News- "Epoka akullnajore" po vjen! El Nino sjell valën polare, dimër i pazakontë në horizont

Top Channel/ SHBA: Shqipëria aleat kyç, mbështesim SPAK

| Lajme | Bota | Sport | Pop News | Programe | Top Channel |
|---|---|---|---|---|---|
| Lajmet e fundit | Opinion | Kombëtarja | Showbiz | Big Brother VIP | Rreth Top Channel |
| Politikë | Koment | Kategoria Superiore | Lifestyle | Për'puthen | Bileta |
| Kronikë | Kosova dhe Rajoni | Kategoria e Parë | Fashion | Shqipëria LIVE | Kontakt |
| Aktualitet | Shkencë dhe Teknologji | Premier League | Shëndeti | Fiks Fare | Puno në Top Channel |
| Ekonomi | Auto | La Liga | Dieta | Video | Privacy Policy & Terms of Use |
| Sociale | | Serie A | Receta gatimi | Të gjitha programet | Aksesueshmëria |
| Video | | Shumësportësh | | Guida TV | |
| Top News LIVE | | Sport Gossip | | | |

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.